

Leksion V-VI-VII

Gjuha si element themelor i kulturës

Cështjet:

1. Gjuha dhe kultura
2. Rrezatimi dhe përhapja kulturore.
3. Gjuha si mishëruese e lidhjeve të bartësve me një truall të caktuar.
4. Kultura e gjuhës si pjesë përbërëse e kulturës kombëtare.
5. Norma letrare dhe kultura e gjuhës.
6. Gjuha standarte dhe marrëdhëniet e saj me dialektet.

1. Gjuha dhe kultura

Fjala kulturë, si term shkencor, u referohet problemeve shoqërore e materiale të tilla, si: mënyra e jetesës, shijet, parapëlqimet dhe qëndrimet ndaj ushqimit, arkitekturës; normat dhe zakonet shoqërore, sistemi i edukimit dhe i arsimit. Pra me kulturë duhet kuptuar tërësia e dijeve dhe e shprehive praktike, e besimeve, e normave morale dhe jurusdike, e vlerave materiale dhe shpirtërore të një shoqërie. Çdo shoqëri njerëzore ka një grumbull normash dhe dijesh, të cilat njeriu i mëson pak e nga pak, duke filluar që nga çasti kur lind e deri në fund të jetës së tij.

Kultura lidhet ngushtë me gjuhën, e cila është pjesë përbërëse e saj. Kultura mbështetet në një shkallë të madhe në gjuhën, pasi kjo shërben si mjet për krijimin, pasurimin, ruajtjen dhe përcjelljen e trashigimisë kulturore nga një brez në tjetrin. Pa gjuhë, nuk mund të ruhej e të transmetohej përvoja e përfutur në përgatitjen e veglave, në gjuetinë e kafshëve, në përdorimin e zjarrit etj. Marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës janë lidhje ndërvlerësie: rrënjat kulturore ndikojnë në zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës, por edhe gjuha ndikon në zhvillimin kulturor të shoqërisë. Mund të thuhet se ekziston një lidhje e ndërsjelltë midis risive dhe ndryshimit kulturor: ndërsa risia shkakton ndryshimin kulturor, ky i fundit nxit risi të mëtejshme. Të reja e përftuara nga zhvillimi i gjithanshëm i shqiptarëve nuk mund të pasqyrohen edhe në risi dhe prurje përsëritëse të gjuhës shqipe, sidomos të leksikut dhe të etnografisë së të folurit ndër shqiptarë.

2. Rrezatimi dhe përhapja kulturore

Procesi i përhapjes në hapësirë të një ideje ose shpikjeje, i teknologjisë ose i prodhimeve nga zona e tyre burimore në hapësira të kulturave të tjera quhet përhapje kulturore. Mund të thuhet se edhe gjuha, si element kulture, ka pasur, ka e do të ketë kurdoherë marrëdhënie të ngushta me risitë dhe frytet e tyre, me përhapjen kulturore dhe me çfarëdo zhvillimi të natyrshëm a shndërrimi të hovshëm shoqëror, ekonomik e ideor. Treguesi më i qartë, dhe mjaft i dukshëm është, së pari, shtegtimi i emrave. Treguesi më i qartë,

dhe mjaft i dukshëm është, së pari, shtegtimi i emrave të prodhimeve të ndryshme nga një gjuhë në tjetrën, si kafeja, çaji, sheqeri etj, fjalë të cilat kanë pothuajse të njëjtën rrënjë, por me ndryshime të pjesshme fonetike. Edhe më qartë kjo dukuri e shtegtimt të fjalëve bashkë me mallrat , traditën dhe kulturën paditet me anë të emërtimeve të përbëra nga **emri i produktit + emrin e vendit** prej e ka zanafillën, si p.sh *çaj kinez, hurma Arabie*, sallatë ruse etj. Kjo edhe në hapësira të më të ngushta ose nga një krahinë në tjetrën, brenda të njëjtës hapësirë kombëtare dhe etnike, si *djathë Gjirokastrë, djathë bjeshke, verë kallmeti* etj.

Nëpërmjet gjuhës, sidomos me anë të emërtimeve të shprehura me togfjalësia ku elementi i dytë është mbiemër etnik a kombëtar, merren edhe njohuri të tjera mirfilli kulturore, si p.sh për mënyrën e jetesë, për veshjen për stilin e të jetuarit. Të tilla janë: vishem *alla franga, alla turka*, ku ngërthehen emrat e kulturave të popujve të ndryshëm.

3. Gjuha si mishëruese e lidhjeve të bartësve me një truall të caktuar.

Gjuha e çdo populli shpreh kulturën e tij dhe i jep atij njësi (unitet) komunikimi. Për këtë arsye gjuha përbën elementin më të përdorur në identifikimin e popujve e të ndarjes së tyre gjeografike. Përfillja e gjuhës si tipar themelor tregues i një populli është më e fortë sesa kufiri politik e shtetëror i një vendi.

Nëpërmjet gjuhës transmetohet në kohë pasuria e përbashkët kulturore e popullit, ruhen traditat dhe zhvillohet më tej kultura kombëtare, duke i dhënë edhe homogjenitetin e duhur bashkësisë etnike e kombëtare përkatëse. Njerëzit janë të interesuar që gjuha dhe kultura e tyre tradicionale të mësohen nga fëmijët e tyre për të siguruar trashigiminë e kulturës e të traditave të veta kombëtare në brezat pasardhës. Por kjo nuk ka qenë gjithmonë e mundshme (sidomos pushtimet e pengojnë këtë gjë).

4. Kultura e gjuhës si pjesë përbërëse e kulturës kombëtare.

Përvetësimi i gjuhës standarte shpreh vetëdijen e krijuar se vetëm gjuha që përfaqëson krejt kombin, domethënë se vetëm gjuha e përbashkët gjithëkombtare mund të përmbushë këkesat e tij më të larta shpirtërore.

Kjo vetëdije e formuar është sukses i madh në procesin e përvetësimit të normës letrare, sepse siguron ardhshmërinë e gjuhës letrare të njësuar, por edhe përpjekjet e pandërprera për ngritjen e kulturës së gjuhës letrare në shkallë sa më të lartë. Shkalla e përvetësimit të gjuhës letrare, praktikisht, bëhet tregues që provon nivelin e kulturës sonë në përgjithësi. Këtë ndërgjegje gjuhësore e kanë përforcuar edhe hapat që janë bërë për drejtshkrimin, njësimin dhe normativizimin e gjuhës shqipe. Që gjatë Rilindjes e më pas, në shtypin shqiptar janë zhvilluar shumë diskutime për probleme të ndryshme të kulturës së gjuhës. Aksioni më i madh shkencor në fushën e kulturës së gjuhës qe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor, 1972). Në pajtim me udhëzimet e shprehura në këtë Kongres u hartuan “*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*” (1973) dhe “*Fjalori drejtshkrimor*” (1974). Vepra më e rëndësishme në këtë fushë janë edhe: “*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*” (1976) “*Rregulla të pikësimit në gjuhën letrare shqipe*” (1973). Mbështetje themelore për ngritjen e nivelit të kulturës së gjuhës janë bërë edhe veprat

“Fjalor i gjuhës së sote shqipe” (1980) dhe *“Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe”* (1976). Më 1979 u krijua edhe Komisioni i përhershëm për pastrimin e pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe.

Interesimi për problemet e kulturës së gjuhës dhe trajtimi i tyre në shtyp ka ardhur duke u rritur edhe në Kosovë.

Është e qartë, pra, se kultura e gjuhës është pjesë përbërëse dhe mjet shprehjeje i kulturës sonë kombëtare. Së këndejmi rrjedh edhe përfundimi se, duke njësuar, pasuruar dhe përsosur gjuhën tonë letrare kombëtare, i japim ndihmë të madhe kulturës sonë kombëtare, zhvillojmë dhe përmirësojmë pareshtur mjetin kryesor të shprehjes së kësaj kulture.

Kultura e gjuhës nuk është aspak anë e jashtme. Ka kulturë gjuhësore ai njeri që kujdeset për ta shkruar e për ta folur gjuhën e vet në pajtim me rregullat përkatëse. Si degë e gjuhësisë, kultura e gjuhës merret me studimin dhe përcaktimin e normës letrare në të gjitha nivelet e sistemit të gjuhës, me zbulimin e prirjeve të zhvillimit të gjuhës për të ndikuar mbi të, si dhe rrugët për përvetësimin e zotimit të normës letrare.

Edukimmi i një *“sjelljeje gjuhësore”* me kulturë të lartë është proces i gjatë, i vështirë dhe që kërkon punë të bashkërenditur nga familja, shkolla e shoqëria. Për këtë thuhet se kultura gjuhësore është njëkohësisht edhe mjet për formimin kulturor të njeriut, edhe fryt i kulturës në përgjithësi. Pasuria ose varfëria gjuhësore është shprehje jo vetëm e prirjeve dhe e shkathtësive të njeriut, po, në radhë të parë, e kulturës së tij shpirtërore. Njeriu mund të mos jetë i shkolluar, por në qoftë se manifeston përpjekjen e shprehjes së logjikshme dhe të bukur, vetvetiu dëshmon nivel më të lartë të kulturës shpirtërore, sesa i shkolluari që, nën lustrën e jashtme, fsheh vetëm zbrastësinë e brendshme.

5. Norma letrare dhe kultura e gjuhës.

Vendosja dhe zbatimi i normës drejtshkrimore është vetëm hapi i parë cilësor drejt kulturës së gjuhës. Drejtshkrimi është një kod i caktuar, që i përket kulturës së të shkruarit, por që, veçanërisht për natyrën e gjuhës sonë, ndihmon e udhëheq edhe punën në lëmin e kulturës së të folurit. Kjo ndodh për arsyen se parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik, i cili synon vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare.

Kultura e gjuhës nuk vjen vetvetiu. Ajo formohet e zhvillohet në mënyrë të ndërgjegjshme, me punë të vijueshme dhe ngulmuese. Për të pasur kulturë gjuhësore e sa më frymëgjatë, çdo shoqëri apo mjedis i saj, që mëton të jetë me kulturë, natyrisht ka edhe strategjinë e vet gjuhësore, të cilën e ushtron në radhë të parë nëpërmjet shkollës dhe organeve të shtypit, botimeve të ndryshme dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv: radios e televizionit kombëtar, teatrit, filmit etj.

Shkollja e përqendron vëmendjen në radhë të parë, në zotërimin e normës gramatikore, drejtshkrimore e leksikore. Zotërimi i normave dhe i rregullave në këto fusha ka rëndësi themelore. Puna që bëhet në shkollë formon te brezi i ri vetëdijen gjuhësore, forcon dashurinë e kujdesin për gjuhën amtare dhe ka vlerën e gurit të themelit në grehinën e kulturës gjuhësore të çdo individi në veçanti dhe krejt gjuhësisë në përgjithësi. Por vetëm puna e shkollës nuk është e mjaftueshme për të arritur shkallën e nevojshme të kulturës gjuhësore. Normat gjuhësore përsosen e përmirësohen vazhdimisht, prandaj duke qenë se ato janë të lidhura ngusht me

kulturën gjuhësore, njeriu gjatë gjithë jetës së tij i del e nevojshme të ndjekë ecjen e këtyre normave, t'i përvetësojë në kohën e duhur elementet e reja të tyre, të përditësohet gjithmonë me risitë në çdo gjë që ka të bëjë me kulturën e gjuhës. Pra, kultura gjuhësore as që mund të kuptohet pa zotërimin e normës, por ajo nuk është e barazvlefshme me normën. Njohja e normave, rregullat gramatikore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore na mësojnë ta shkruajmë e ta flasim gjuhën tonë letrare drejt, pa gabime. Kjo është e domosdoshme, porse kultura e gjuhës parakupton më shumë se kaq; njerëzit kanë nevojë t'i shprehin mendimet e ndjenjat e tyre edhe sa më bukur, sa më qartë e në mënyrë të përpiktë, në përshtatje me rrethanat e mjediset e caktuara e për të përmbushur funksione të caktuara. Këto nuk mund të arrihen vetëm me zbatimin sado të mirë të normës. Krahë saj, kërkohet edhe njohja sa më e mirë e thesarit leksikor-frazeologjik, si dhe e sistemit stilistikor të gjuhës, duhet rrokja e zotërimi i mjeshtërisë për t'i gjetur, zgjedhur e përdorur me efekt të gjitha mjetet shprehëse emocionale e vlerësuese të gjuhës. Duke qenë se kjo është kërkesë themelore e kulturës gjuhësore, kuptohet që njohja e pasurisë së shqipes, si dhe vlerave stilistikore të saj në kohën tonë marrin rëndësi të veçantë, si për shkencën tonë gjuhësore, ashtu edhe për shkollën, edhe për njerëzit e kulturës, arteve, shkencës. Ngritja e shkallës së kulturës gjuhësore të mbarë shoqërisë sonë nuk është vetëm proces subjektiv. Ajo ka edhe anën e vet objektive. Sistemi i gjuhës sonë të përbashkët, që tashmë është krijuar, ka nevojë të përsoset, të bëhet edhe më i qëndrueshëm. Kjo arrihet duke e zbatuar normën letrare.

Kultura gjuhësore ka edhe anën e saj morale. Njeriu që flet gjuhë të kulturuar u shmanget me qëllim shprehjeve të pahijshme, thënieve me fjalë të rënda, fyerjeve. Gjuha është realitet imediat i mendimit, po edhe pasqyrë e edukatës, e koncepteve dhe e moralit të një shoqërie, të mjedisit të saj, po edhe të çdo individi të veçantë që e përdor gjuhën kombëtare.

6. Gjuha standarte dhe marrëdhëniet e saj me dialektet.

Ndikimi i gjuhës letrare ndihet edhe në lëmin e të folurit të përditshëm, i cili pëson ndryshime të vazhdueshme, duke i përngjarë dhe duke u afruar gjithmonë e më shumë me gjuhën standarte. Për këtë arsye brenda çdo të folmeje, vijnë e dallohen tiparet e dy varianteve a dy llojeve të të folurit: a) varianti tradicional, ku spikat ruajtja elementeve të qëndrueshme të sistemit të vjetër b) varianti i ri, që pasqyron më gjërë shndërrimet dhe ndryshimet e këtij sistemi nën tryninë e makrosistemit. Një dukuri e tillë nuk ka se si të mos merret parasysh sidomos në letërsinë artistike, ku fjala luan rolin kryesor në formësimin e gjuhës së karaktereve, në mënyrë që secili të jepet me ngjyresën përkatëse të të folurit si tip shoqëror, gjë që e bën të domosdoshme për shkrimtarin njohjen jo vetëm të dialekteve, por edhe të ndryshimeve që ato pësojnë në kohën tonë. Një tregues i mirë për t'u futur në këto lloje të foluri për shkrimtarin shërben edhe studimi i faktorëve jashtëgjuhësorë, sepse shkalla e ruajtjes së sistemit tradicional të të folmeve ose, e kundërta, shfaqja në të e varianteve të reja, varen nga arsimi, nga niveli i përgjithshëm kulturor i bartësve të së folmes, nga kushtet e jetës së tyre, nga shkalla e pjesëmarrjes së tyre në veprimtarinë prodhuese e në jetën kulturore dhe politiko-shoqërore të vendit.

Është me rëndësi të thuhet se, në kohën tonë, drejtimi i përgjithshëm i ndryshimeve gjuhësore është afrimi i tyre me gjuhën standarte. Kjo dukuri përcaktohet nga veprimi i

dy faktorëve 1. nga fakti se pikërisht në gjuhën letrare të kohës sonë morën shfaqen më të qartë prirjet kryesore të zhvillimit të gjuhës shqipe në përgjithësi dhe 2. nga që ndikimi i gjuhës letrare kombëtare bëhet sot përcaktues e i përçueshëm nëpërmjet të gjithë veprimtarisë shtetërore e shoqërore me shkrim e me gojë. Në shërbim të këtyre faktorëve janë rritja e përgjithshme e kulturës e arsimit, lufta për rrafshimin e ndryshimeve midis qyteti e fshatit. Kushtet e sotme të veprimtarisë jashtë gjuhësore jo vetëm kërkojnë domosdoshmërinë e ndryshimeve të rëndësishme në dialektet: plotësimi i tyre me fjalë të reja, mërgimi i fjalëve a trajtave ngushtësisht krahinore për arsye të zgjerimit të rrethit të komunikimit etj., por edhe krijojnë mundësi për një ndikim të gjuhës letrare në mënyrë të ndërgjegjshme. Folësit e të gjitha zonave, të Veriut e të Jugut, po edhe më tej në viset ku flitet shqipja edhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, janë të ndërgjegjshëm për epërsinë e gjuhës letrare kombëtare; ata dëshirojnë dhe përpiqen të bëhen ushtrues të saj. Të folurit në gjuhën letrare kombëtare është sot shenjë e tregues kulture. Duhet ditur se me gjithë ndikimin intensiv dhe çdo ditë e më të dukshëm të gjuhës letrare mbi të folmet dhe dialektet, nuk ndodh zëvendësimi i thjeshtë i sistemit dialektor me sistemin e gjuhës letrare. Në rrugën e gjatë të këtij procesi të natyrshëm e shumë të gjatë ndodhin ndërrime, rindërtime e shtresësime gjuhësore në të gjitha nivelet dhe në një mënyrë ku, e vjetra dhe e reja, dialektorja dhe standartja marrin e japin me njëra-tjetrën, ngjizen e mbruhën me shoqja-shoqen, duke spikatur më shumë herë njëra,herë tjetra, por kurdoherë në vijën e një procesi dialektik konvergjent, që shpie drejt zotërimit të plotë të gjuhës letrare të përbashkët.

Për arsye të ndikimit të fuqishëm të gjuhës letrare, si dhe nga bashkëveprimi ndër dialektor, aq i përshtatur në kohën tonë, në qytete e fshatra, përherë e më shumë zgjerohet sasia e folësve që rrokin mirë normën letrare, që kalojnë në të folur letrar, por, megjithatë, dialekti nuk zhduket pa lënë gjurmë. Tiparet e mëparshme dialektore shfaqen në formën e një nënshtrese (=substrati) origjinale dialektore. Mbi këtë bazë ne dallojmë p.sh., një shkodran që flet gjuhën letrare dhe një vlonjat apo një korçar. Kemi të bëjmë, pra, me një ngjyresë krahinore të gjuhës letrare dhe jo me thyerje të normave të saj. Kjo ngjyresë, për një farë kohe. Është e pamënjanueshme dhe plotësisht e përligjshme, prandaj, timbret e lehta krahinore që mund të shfaqen edhe ndonjë trupe teatrore, duhen dalluar mirë nga shmangiet nga norma apo nga thyerjet e palejueshme të saj.

Të para në tërësi, marrëdhëniet e gjuhës letrare me dialektet bëjnë të mundur të nxirren edhe disa vlera të mira të dialekteve të mira të dialekteve që vijnë pa pushim në gjuhën letrare.

Duhet të theksojmë pasurimin e gjuhës letrare me fjalë të bukura të krahinave, me ndërrime sintaksore dhe me modele origjinale të gjuhës popullore, të cilat duke iu nënshtruar një përpunimi letrar nga ana e shkrimtarëve, lëshon në lëmin e gjërë të përdorimit masiv. Gjuha e shkencës, e kulturës nuk mund të rrijë e shkëputur nga gjuha popullore, sepse përmes saj ajo ushqehet vazhdimisht, përsoset e pasurohet.

Së dyti, duhet pasur parasysh se gjuha e folur e çdo njeriu, vartësisht nga vendlindja, vendbanimi, arsimi, profesioni etj., pasqyron gjurmët e përvojës dhe të përjetimeve të tij. Fëmija, para se të mësojë gjuhën e vet amtare në trajtën e shkruar, mëson të flasë shqip në variantin familjar të tij, i cili, sipas rastit, mund të jetë, ku më pak e ku më shumë, edhe pamje dialektore.